

Njoftim vendimi

Postuar në : 05/10/2023



Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga Rezarta Schuetz kryesuese, Natasha Mulaj relatores, Albana Shtylla, Ina Rama, Sokol Çomo anëtarë, shpalli vendimin për çështjen (JR) nr. 53/2021, datë 09.09.2021 që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Kreshnik Omari kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 412, datë 06.07.2021.

Në përfundim të gjykimit në dhomë këshillimi, trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë unanime, vendosi:

- Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 412, datë 06.07.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Kreshnik Omari.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 05.10.2023.